



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenit 36, paragrafi 3, të Rregullës Financiare Nr.01/2013-MF – Shpenzimi i parave publike, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe nenit 20 par. 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 31. 01. 2018, pas shqyrtimit të propozim Rregullores nga Kryetari i Komunes miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR
KUSHTET,KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE
15NR.011-70915 E DATËS 28.12.2016

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i miratimit të kësaj Rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i nenit 23 dhe 24 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016 si dhe shtimi i një neni të ri pas nenit 27 me përmbajtje si vijon:.

2. Neni 23 – Subvencionet për Organizatat joqeveritare riformulohet si vijon:

1. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për OJQ-të e ndryshme të cilat janë aktive për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të tyre të ndryshme në interes të Komunës .
2. Çdo ndarje e subvencioneve për OJQ-të që tejkalon shumën prej 500 €, bëhet në bazë të dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe

Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve përveç rasteve të gjendjes së jashtëzakonshme .

3. Për ndarjet që nuk tejkalojnë shumën prej 500 €, zbatohen dispozitat e kësaj Rregulloreje . Në raste të tilla ndarja e subvencioneve bëhet pa shpallje publike me Vendim të Kryetarit të Komunës sipas kërkesave të arsyetuara të OJQ-ve .

3. Neni 24 –Dokumentacioni i kërkuar për Organizatat joqeveritare riformulohet si vijon:

1. Në rast se ndarja e subvencioneve tejkalon shumën mbi 500 €, atëherë edhe dokumentacioni do të kërkohet konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe Procedurat e Financimit Publik t OJQ-ve .
2. Për shumat që nuk tejkalojnë shumën mbi 500 €, Organizatat joqeveritare të cilat parashtrojnë kërkesë për mbështetje financiare duhet të prezentojnë dokumentacionin si vijon:

- 2.1 Çertifikatën e regjistrimit të personit juridik,
- 2.2. Çertifikatën e numrit fiskal,
- 2.3. Kopjen e kartelës bankare të personit juridik,
- 2.4. Fotokopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve,
- 2.5. Autorizimi,
- 2.6 Projekti ,
- 2.7. Plani financiar,
- 2.8 Varësisht nga lloji i kërkesës mund të kërkohej edhe dëshmi tjera plotësuese.

3. Pas nenit 27 shtohen një nen i ri neni 28 me përmbajtje si vijon:

Neni 28

Subvencionimi i praktikantëve

- 1.Komuna mund të subvencionojë praktikantët të cilët aplikojnë në kuadër të institucioneve publike nën menaxhimin e Komunës .
2. Për pranimin e praktikantëve të cilët do të subvencionohen nga Komuna do të mirret Vendim i veçantë në Kuvendin Komunal ku do të përcaktohet edhe shuma e subvencionimit.
- 3.Pas marrjes së Vendimit në Kuvendin e Komunës do të shpallet Konkurs publik për pranimin e praktikantëve nëpër ata sektorë ku është më tepër e nevojshme për Komunën një herë brenda vitit dhe në raste të domosdoshme edhe më shumë se një

herë në vit. Aplikantët do të dorëzojnë dokumentacionin sipas kushteve të përcaktuara në Konkurs.

4. Pas shtimit të një neni të ri pas neni 27 përkatësisht neni 28 ndryshojnë edhe numrat e neneve në vijim ashtu që neni 28 bëhet neni 29, neni 29 bëhet neni 30, neni 30 bëhet neni 31, neni 31 bëhet neni 32 bëhet neni 33.

Neni 2

Rregullorja hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

15Nr. 011-6520
Lipjan, më 01. 02. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



KRYESUESI I KUVENDIT
Daut Azemi